



Dalës-Izlazna

Nr. - / - 37  
Br.

Data 28.03.2023  
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

### KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 58 shkronja (h) dhe nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 e dt.04.06.2008), neni 27 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 34 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72, pika 1.8 dhe nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34, i dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, nr.-II-270, të dt.21.03.2023, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.28.03.2023, mori këtë:

## V E N D I M

**Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq.**

### Neni 1

Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e Njërive Kadastrale si në vijim :

- **P-72614055-00065-3**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi actual i parcelës: Bujqësore-kullosat – kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 8160 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA** ;
- **P-72614055-00065-7**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi actual i parcelës: Bujqësore-kullosat – kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 470 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA** ;
- **P-72614055-00034-1**, Tipi i Pronës / Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi actual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 6; me sipërfaqe prej 18016 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA** ;
- **P-72614055-00036-0**, Tipi i Pronës / Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi actual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 20258 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA** ;
- **P-72614055-00037-0**, Tipi i Pronës / Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi actual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 10841 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00038-0**, Tipi i Pronës / Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore-Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 10292 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur:Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA**;

- **P-72614055-00058-0**, Tipi i Pronës / Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore-Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 20471 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: Markovac e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA dhe** ;

**P-72614055-01850-37**, (1)Llojiishfrytëzimittëparcelës : Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Oborr; me sipërfaqeprej 144 m<sup>2</sup> ;(2)Llojiishfrytëzimittëparcelës : Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Shtëpi - Ndërtesë; me sipërfaqeprej 16 m<sup>2</sup>; sipërfaqja e përgjithshme 160 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq ; Vendii quajtur: Novi Obiliq e cila evidentohet në emër të **PSH.I NDUSTRIA E DERIVATEVE TË NAFTËS D.S. TRG.NAFT. DERIVATA ZAGREB.**

#### **Neni 2**

Qëllimi i paraqitjes së këtij Vendim për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik për njësitë kadastrale të cekura si në nenin 1 të këtij Vendimi është Shpronësimi i këtyre Njësive Kadastrale për nevoja të Komunës së Obiliqit, në të cilat planifikohet realizimi i projekteve të ndryshme .

Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme, që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin .

#### **Neni 3**

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës ( Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

#### **Neni 4**

Pas miratimit të këtij Vendimi për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër dhe Drejtoria e Financave .

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit

